



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 12.09.2022, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 06.09.2022.
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Gusht 2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV dhe çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për periudhën 01.08.2022 – 31.12.2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.
3. Mbi miratimin e kontratës së shit-blerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a. për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “OST” sh.a. për transferimin e asetëve të investimit të kryer nga zbatimi i projektit “Supply and Instalation of Transmission Meter/Data Center” nga OST sh.a., tek OSHEE Group sh.a..
5. Mbi një ndryshim në vendimin e licencimit të shoqërisë “Breçani R.O.S.P” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Drita”, me kapacitet të instaluar 1980 kW.
6. Mbi shqyrtimin e ankesës së konsumatorit A. Ç. ndaj Furnizuesit të Shërbimit Universal FSHU sh.a. dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a..